



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Nr. I prot. 1041 Më 04.03.2026
-III- Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

Komuna e Rahovecit / Opštine Orahovac / Municipality of Rahovec



Mbështetur në Ligjin Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, neni 14, pika 14.2, Ligjin për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Statutit të komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Neni 20 pika 1.1 të Rregullores për Taksa komunale 01/80, vendimit të kuvendit komunal të Rahovecit Nr. 01/57 të datës: 30.05.2025 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës së Rahovecit, komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, i caktuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nr.01/88, të datës 26.1.2026, në mbledhjen e mbajtur më 2.3.2026, shpall këtë:

NJOFTIM PËR ANKAND PUBLIK

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR

1. Njoftimi publik për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës, përmban si në vijim:

1.1. Prona e paluajtshme komunale gjendet në Rahovec, Rr. "Xhevat Kasapi" p.n., ngastra kadastrale nr. P-71510057-01830-01, zona kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur ISPOD SELA. Në shfrytëzim do të jepet vetëm "kafiteria në parkun e qytetit", në sipërfaqe prej 132 m² (njëqind e tridhjetë e dy metra katrorë), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 5813 m² (pesë mijë e tetëqind e trembëdhjetë metra katror). Sipërfaqja e jashtme e parkut do të mirëmbahet nga përfituesi i ankandit dhe do të jetë në shërbim të qytetarëve.

Njoftimi për ankand publik përfshin:

1.1. Çmimin fillestar të pronës komunale të cekur në pikën 1.1.:

1.2. 2.50 € për m², me qira mujore prej 330.00/€;

1.3. Afatin e dhënies në shfrytëzim të pronës:

Afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës do të jetë afatshkurtër, prej 5 (pesë) vjetësh.

1.4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim:

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale.
3. Kafiteria në parkun e qytetit do të jepet në shfrytëzim për pushim dhe rekreacion dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

3.1. Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik dhe data e fundit e dorëzimit të ofertave:

Kohëzgjatja e shpalljes së ankandit publik për dhënien e pronës për shfrytëzim afatshkurtër është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në faqen ueb të Komunës, në vendet publike, elektronike dhe të shkruara. Ofertat dorëzohen të mbyllura nëpërmjet Zyrës së Prokurimit në Rahovec nga data **5.3.2026 deri më 19.3.2026, nga ora 09:00 deri në orën 15:00.**

Vendi, koha ku do të mbahet hapja e ofertave të ankandit publik:

Në sallën e Kuvendit Komunal, më datë **23.3.2026 (e hëne)**, me fillim në orën **13:30**, do të bëhet hapja e ofertave të mbyllura dhe do të bëhen publike gjatë hapjes, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.

3.2. Kushtet apo kufizimet mbi dhënien e të drejtave për shfrytëzim:

- 3.2.1. Prona nuk mund të përdoret për qëllime të tjera përpos siç është përcaktuar me ankand publik dhe nuk mund të bartet në personin e tretë.

II. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:

- Të drejtë pjesëmarrjeje kanë personat fizikë dhe juridikë;
- Personat fizikë, krahas aplikacionit në kuvertë, duhet të ofrojnë edhe:
 - Kopjen e letërnjoftimit;
 - Dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë me afat;
 - Certifikatën nën hetime (lëshuar nga gjykata kompetente);
 - Deklaratën nën betim të nënshkruar (ky dokument është pjesë e dosjes së ankandit).
- **Personat juridikë**, krahas aplikacionit në kuvertë, duhet ta bashkëngjisin edhe:
 1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me informata (NUI);
 2. Vërtetimin e taksës komunale në afarizëm;
 3. Vërtetimin nga Administrata Tatimore e cila ka afatshmëri;
 4. Kopjen e letërnjoftimit të pronarit apo të personit të autorizuar (vlen për persona juridikë);
 5. Certifikatën nën hetime (lëshuar nga gjykata kompetente);
 6. Deklaratën nën betim të nënshkruar (ky dokument është pjesë e dosjes së ankandit).

- **Kriteret për aplikim: Oferta ekonomikisht më e favorshme**
 - 4.1. Çmimi me i lartë i qirasë mujore.....50 pikë
 - 4.3. Plani investiv për 5 (pesë) vjet..... 50 pikë
- Totali i pikëve 100 pikë**

4. Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në ankand publik:

4.1. Pjesëmarrësve në konkurrim iu garantohet e drejta që të:

- 4.1.1. Informohen lidhur me procedurat e ankandit publik;
- 4.1.2. Shohin pronën që do të jepet në shfrytëzim;
- 4.1.3. Kanë qasje në dokumentacionet e pronës;
- 4.1.4. Tërhiqen nga ankandi jo më vonë se tre (3) ditë para mbajtjes së ankandit publik;
- 4.1.5. Fituesi duhet të nënshkruajë regjistrin e procedurës së ankandit publik. Nëse informatat e dhëna nga ofertuesi dëshmojnë si të pasakta, komisioni ka të drejtën që të refuzojë dhënien e pronës në shfrytëzim.

5. Raporti i vlerësimit të ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:

5.1. Komisioni vlerësues brenda tri (3) ditë pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave në ankand publik, harton raportin përfundimtar për përmbylljen e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

5.2. Raporti përfundimtar i komisionit vlerësues të ofertave të ankandit publik përmban:

- 5.2.1. Kopjen e shpalljes së ankandit publik;
- 5.2.2. Procesverbalin e procesit të ankandit publik;
- 5.2.3. Rekomandimin e komisionit për zgjedhjen e fituesit;
- 5.2.4. Kopjen e protokolluar të ofertës së përzgjedhur;
- 5.2.5. Ankesat e parashtruara nga pjesëmarrësit në ankand publik.

6. Pas miratimit të ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues, njoftimi i dërgohet fituesit dhe publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në faqen ueb të Komunës. Ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar në pliko të mbyllura, do të shpallet fitues gjatë procesit të hapjes së ofertave.

7. **Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në komisionin për vlerësimin e ankesave në afat prej shtatë (7) ditësh.**
8. Nëse komisioni i ankesave konstaton që ka shkelje gjatë procesit të vlerësimit, ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e procesit, por nëse komisioni i ankesave vlerëson se nuk ka bazë, atëherë ankesën e refuzon si të pabazuar.
9. Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe fituesi i zgjedhur, brenda 15 ditësh pune nga data e miratimit të ofertës nga ana e komisionit vlerësues.

Vërejtje: Tërheqja e aplikacioneve për konkurrim në ankand publik bëhet në formë fizike në Zyrën e Prokurimit në Rahovec.

Rahovec, 4.3.2026